



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 667 prot.

Tiranë, më 9.6.2020

Lënda: Mbi zbatimin e detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"

FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT

Tiranë

Në kuadër të zbatimit të detyrave dhe përgjegjësisë të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Zyra e Komisionerit") ushtron monitorime të vazhdueshme lidhur me zbatimin nga ana e Autoriteteve Publike të detyrimeve që burojnë nga ky ligj.

Në këtë këndvështrim, nga monitorimi i kryer në faqen zyrtare: <http://www.albaniaandf.org>, është konstatuar se institucioni juaj nuk ka përmbushur detyrimin ligjor në përputhje me nenin 7 "*Kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë*" të ligjit të sipërcituar, në të cilin përcaktohet se, *në përputhje me programin e transparencës të miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e informacionit të përcaktuara në këtë nen.*

Përsa më sipër, Zyra e Komisionerit kërkon të merrni masa menjëherë, për publikimin e programit të transparencës në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 7 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", në faqen zyrtare të institucionit tuaj në internet, duke vënë në dijeni njëkohësisht edhe Zyrën e Komisionerit.

Në përputhje me nenin 10 të ligjit të sipërcituar, me qëllim bashkërendimin e punës për garantimin e së drejtës për informim, Autoriteti Publik duhet të njoftojë Zyrën e Komisionerit për ndryshimet e koordinatorit për të drejtën e informimit si dhe kontaktet e tij.

Gjithashtu, ju bëjmë me dije se me qëllim bërjen sa më efektive të së drejtës për informim si një e drejtë kushtetuese dhe një mjet për garantimin e llogaridhënies së autoriteteve publike, Zyra e Komisionerit ka ngritur "Regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit" (REKPD1) në portalin "Pyetshtetin.al".

Ky regjistër garanton monitorimin në kohë reale të depozitimit dhe trajtimit të kërkesave/ankesave. Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 145, datë 13.03.2018, është sanksionuar përdorimi i detyrueshëm i këtij regjistri nga Autoritetet Publike. Aktualisht regjistri është instaluar dhe është operativ në 31 Autoritete Publike.

Përsa më sipër, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave të sipërcituar, lutemi të merrni masa për instalimin e sistemit të regjistrit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve brenda datës 30 qershor 2020.

Theksojmë se instalimi i këtij regjistri, përveçse detyrim ligjor, është shumë i rëndësishëm për të rritur transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve publike "vis-à-vis" qytetarëve dhe OJF-ve.

Në rast mosveprimi nga ana juaj për çështjet e sipërcituara, Zyra e Komisionerit, do të vlerësojë mbi ndjekjen e procedurës së mëtejshme në përputhje me nenin 18 dhe 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Për çdo paqartësi në lidhje me instalimin e këtij regjistri mund të kontaktoni me Zyrën e Komisionerit, në adresën elektronike info@idp.al ose në numrin e telefonit +35542237200.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

